




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETAR I K.K.T.

**Z. EDI RAMA**



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**Znj. BELINDA BALLUKU**



**PLANI I DETAJUAR I ZHVILLIMIT TË**

**PLANIT TË DETAJUAR TË ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK)  
MES LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE LUMIT SEMAN, I RISHIKUAR**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, Datë 14.10.2020

Hartuar nga

**AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**



## Përmbajtja

1. Nevoja për hartimin e PDZRK-së dhe Qëllimi i tij .....	3
1.1. Nevoja për PDZRK dhe qëllimi i tij .....	3
1.2. Kufiri i PDZRK-së .....	3
2. Baza Ligjore .....	5
2.1. Legjislacioni .....	5
2.2. Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjakë-Karavasta .....	5
2.3. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit .....	9
2.4. Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar .....	12
2.5. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Divjakë.....	13
3. Propozimet territoriale.....	15
3.1. Përdorimi i Tokës .....	15
3.2. Detajet e investimeve të miratuara .....	16
3.3. Plani i infrastrukturave teknike.....	17
3.4. Plani i mbrojtjes së Peizazhit.....	18
Shtojca 1 .....	19
Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike.....	19
Shtojca 2 .....	20
Harta .....	20



# 1. Nevoja për hartimin e PDZRK-së dhe Qëllimi i tij

## 1.1. Nevoja për PDZRK dhe qëllimi i tij

Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare hartohet bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e qendrueshëm të zonave më rëndësi kombëtare.

Nevoja për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, vjen si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) për miratimin e një sërë investimesh që prekin Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta dhe Brezin Bregdetar.

Hartimi i PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman përbën një detyrim ligjor në bazë të përcaktimeve të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe VKM-së Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Neni 32 i së cilës përcakton se:

- 1. Zhvillimi i zonave të rëndësisë kombëtare në përputhje me kufizimet dhe kushtëzimet e legjislacionit sektorial, kryhet nëpërmjet lejeve të ndërtimit, në territore me kushte zhvillimi të paracaktuara si rezultat i proceseve të planifikimit të territorit;*
- 2. Kur zhvillimi propozohet në zona të paurbanizuara, territori përkatës pjesë e zonës së rëndësisë kombëtare duhet t'i nënshtrohet detyrimisht një planifikimi të detajuar e të posaçëm.*
- 3. Ky proces planifikimi kryhet nëpërmjet hartimit të Planit të Detajuar të Zonës me Rëndësi Kombëtare.*

Përcaktimi për hartimin e PDZRK-së për territorin mes Karavastasë dhe Semanit është dhënë gjithashtu nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Divjakë, miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 9, datë 08.02.2017, ku ndodhet pjesa më e madhe e territorit të investimeve strategjike të miratuara.

Lidhja e PDZRK-së me investimet strategjike jepet në VKM-në Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Neni 33, Pika 2:

*“Objekti i Planit të Detajuar për një Zonë të Rëndësisë Kombëtare janë ndër të tjera dhe:*

*b) Investime të rëndësishme dhe strategjike që nxisin zhvillimin e territorit dhe kanë ndikim kombëtar.”*

Në vijim të miratimit të propozimeve për investime strategjike, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (ASHZHI), si institucion qendror në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe sekretariat i KIS, Nr. 99 Prot datë 08.05.2018, i drejtohet AKPT duke i kërkuar ndërmarrjen e nismës për hartimin e PDZRK-së, për zonën Karavasta-Seman si dhe kryerjen e procesit të bashkërendimit për hartimin e tij.

Në vitin 2020, ASHZHI me shkresën Nr. 187/9 Prot datë 09.07.2020, i drejtohet AKPT-së duke kërkuar rishikimin e Planit të Zonës së Rëndësisë Kombëtare Karavasta – Seman, të miratuar me Vendimin Nr. 3, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.


Qëllimi i PDZRK-së është rregullimi i zhvillimeve dhe infrastrukturave në funksion të aktiviteteve parashikuar nga investimet strategjike, duke siguruar bashkërendimin dhe respektimin e legjislacionit sektorial dhe dokumenteve të planifikimit në fuqi për territorin subjekt zhvillimi.

## 1.2. Kufiri i PDZRK-së

Kufiri i PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman i përgjigjet vendimeve të KIS dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave për investimet strategjike, si edhe ndarjet në njësi strukturore sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor Divjakë.

Këto territore shtrihen në Zonën me Rëndësi Kombëtare të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, shpallur zonë e mbrojtur me VKM Nr. 687 datë 19.10.2007, dhe Zonës me Rëndësi Kombëtare të Brezit Bregdetar, shpallur si e tillë me VKM Nr. 881 datë 14.12.2016.

Zona në studim ka një sipërfaqe totale prej **2.057 ha**, dhe bën pjesë në Njësinë Administrative Remas, Bashkia Divjakë.



Harta 1. Kufiri i PDZRK Karavasta-Soman



## 2. Baza Ligjore

### 2.1. Legjislacioni

Baza kryesore ligjore për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare është Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” si dhe VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

PDZRK bazohet gjithashtu në legjislacionin sektorial në fushat e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mjedisit, energjisë, bujqësisë, turizmit, si më poshtë:

- Ligji Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”;
- Ligji Nr. 7/2017 “Per nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;
- Ligji Nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”;
- Ligji Nr. 9180, datë 05.02.2004, “Për statistikatat zyrtare”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 348, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020”;
- VKM Nr. 10026 datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”;
- VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për miratimin e projekteve me statusin “projekt me potencial strategjik”;
- VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi”;
- VKM Nr. 580, datë 28.8.2019 “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020
- VKM Nr. 687, datë 19.10.2007 “Për shpalljen me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta, “Park Kombëtar”;
- Urdhër i Ministrit të Mjedisit Nr. 782, datë 30.12.2015, “Për Miratimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjakë-Karavasta”;
- VKM Nr. 881, datë 14.12.2016, “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”;
- Vendim i KKT-së Nr. 2, datë 14.06.2016, “Për miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar”;
- Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike që prekin zonën.

PDZRK gjithashtu merr në konsideratë vendimet e mëposhtme të Këshillit Kombëtar të Territorit:

Vendim i KKT-së Nr. 9, datë 08.02.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Divjakë”;

### 2.2. Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjakë-Karavasta

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK) është shpallur Park Kombëtar (kategoria II e mbrojtjes sipas IUCN) në përputhje me VKM Nr. 687, datë 19.10.2007 ‘Për shpalljen, me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta Park Kombëtar”.

Kjo zonë është pjesë e Konventës së Ramsar-it që prej vitit 1995 dhe mban numrin 781 në regjistrin Ramsar të ligatinave me rëndësi ndërkombëtare (29.11.1995).

Zona e PKDK është shpallur gjithashtu zonë Ramsar me VKM Nr. 413, datë 22.8.1994 “Për shpalljen e lagunës së Karavastasë dhe Parkut të Divjakës si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur për t’u përfshirë në listën e Konventës së Ramsarit”.

Territori i Parkut menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në bazë të Planit të Menaxhimit (PM) të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Divjakë-Karavasta, hartuar në shtator 2014 nga JICA (Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar) dhe të miratuar me Urdhin Nr. 782, datë 30.12.2015 të Ministrit të Mjedisit.

Planet e Menaxhimit qendrojnë në fuqi për një periudhë 10 vjeçare dhe kanë për qëllim kryesor krijimin e platformës ligjore, shkencore, administrative dhe financiare për institucionet përgjegjëse dhe palët e interesuara, me qëllim që të arrihet objektivi kryesor i Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, për ruajtjen dhe përmirësimin e biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të peizazhit, për përfitime të qëndrueshme të komunitetit lokal nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Në përputhje me legjislacionin kombëtar në lidhje me zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin dhe politikat ndërkombëtare, konventat dhe protokollet përkatëse, ku Republika e Shqipërisë është palë, direktivat e Bashkimit Evropian si Direktiva e Habitatave dhe Shpendëve, në të gjithë territorin e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta aktivitetet e mëposhtme janë të ndaluara:

- a. Përdorimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në strukturën, biodiversitetin dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
- b. Hedhja, ruajtja apo asgjësimi i çdo lloj mbeturinave urbane me origjinë jashtë territorit të parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta;
- c. Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara urbane dhe industriale;
- d. Shpërndarja e kafshëve dhe bimëve jo autoktone në rastin kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;
- e. Riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut dhe llojeve të tjera të faunës me përjashtim të riprodhimit për konservim;
- f. Ndërtimi i rrugëve të reja, hekurudhave, zonave të reja urbane, linjat mbi dhe nëntokësore të tensionit të lartë dhe të naftës dhe gazsjellësve;
- g. Larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;
- h. Introdhimi i llojeve jo-vendase;
- i. Ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
- j. Qarkullimi i mjeteve të transportit jashtë rrugëve;
- k. Gjuetia dhe shqetësimi i faunës së egër;
- l. Nxjerrja e mineraleve, gurëve, zhavorrit, dhe torfës;
- m. Ndërtimi dhe funksionimi i objekteve industriale dhe energjitike;
- n. Veprimtari masive sportive, turistike, jashtë vendeve të përcaktuara;
- o. Organizimi i garave me automobilë dhe motoçikleta.
- p. Grumbullimi i paautorizuar i bimëve medicinale dhe aromatike, kërpudhave dhe produkteve të tjera dytësore pyjore;
- q. Ndryshimi dhe modifikimi i rrjedhave të ujit dhe trupave ujore.



No of point	Form of borderline
①—②	River(Shkumbin)
②—③	Road(Seasonal)
③—④	Road(Well-kept gravel)
④—⑤	Road(National asphalted)
⑤—⑥	Road(Seasonal)
⑥—⑦	Hill Ridge-line
⑦—⑧	Road(Seasonal)
⑧—⑨	Road(Well-kept gravel)
⑨—⑩	Road(Seasonal)
⑩—⑪	Chanel
⑪—⑫	Road(Seasonal)
⑫—⑬	River(Seiman)
⑬—⑭	Coastline
⑭—⑮	One km line from coastline
⑮—①	Coastline



Harta 2. Zonimi i PKDK sipas Planit të Menaxhimit


Nga sipërfaqja totale prej 2.057 ha subjekt e PDZRK, 1.636,5 ha bën pjesë në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK). Nga kjo sipërfaqe, 865,3 ha bëjnë pjesë në **Nënzonën e Përdorimit të Qëndrueshëm (ZPQ)** të PKDK, ndërsa 771,2 ha bëjnë pjesë në **Nënzonën e Përdorimit Tradicional (ZPT)** të PKDK.

Plani i Menaxhimit të PKDK jep përcaktimet e mëposhtme për këto zona:

- **Në Nënzonën e Përdorimit të Qëndrueshëm (ZPQ):**
  - o lejohen aktivitetet ekonomike, pas pajisjes me leje mjedisore;
  - o ndalohen:
    - introduktimi i peshqve dhe specieve ujore jo autoktone;
    - akuakultura intensive;
    - shqetësimi i zonës së folenizimit të pelikanit në distancë prej 300m;
    - peshkimi me mjete motorrike;
    - ndërtimi i hapësirave të banimit.
  
- **Në Nënzonën e Përdorimit Tradicional (ZPT):**
  - o lejohet vazhdimi i aktiviteteve tradicionale dhe ekonomike, si dhe aktivitetet e reja pas pajisjes me leje mjedisore;
  - o ndalohet:
    - ndezja e zjarreve dhe hedhja e mbetjeve të ngurta në tokat bujqësore;
    - heqja e dheut dhe hapja e një sistemi të ri kullimi;
    - mbjellja e bimëve jo autoktone.



Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Llagunës së Karavastës dhe Lumit Seman  
Zona e PDZRK dhe Zonimi i PKDK sipas Planit të Menaxhimit



Harta 3. PDZRK dhe Zonimi i PKDK sipas Planit të Menaxhimit



### 2.3. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit


Parimet kryesore që rrjedhin nga PPK në lidhje me sistemin Bujqësor dhe që prekin zonën në studim janë:

- Ruajtja e fondit të tokës bujqësore;
- Konsolidimi i tokës bujqësore;
- Modernizimi i sistemit bujqësor.


Zona gjithashtu ndodhet në rajonin më të favorizuar për shfrytëzimin e energjisë diellore sipas studimeve të bëra nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duhet specifikuar që zona në studim sipas PPK ndodhet në zonën e rrezikut ndaj përmbytjeve.

Nga PPK për zonën nuk parashikohen zhvillime urbane, në infrastrukturë apo industri.



Harta 4. Harta e Përmbytjeve (Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit)



LEGJENDA

- Korridor i rëndësishëm infrastrukturor
- Korridor pejzazhistik bregdetar
- Korridor pejzazhistik
- Kooperim ndër - rajonal
- Qytet portë
- Nyje multimodale
- Hub i specializuar  
(logjistik, bujqësor, energjetik)
- Konsolidim + Përforcim
- Fuqizim + Rigjenerim
- Konsolidim + Rigjenerim
- Rigjenerim + Përforcim
- Lokalitete
- Pikë kufitare
- Aeroport
- Port kryesor
- Port energjetik
- Marina turistike
- Numri i popullsisë deri në 1,000

- 1,001 - 3,000
- 3,001 - 5,000
- 5,001 - 10,000
- 10,001 - 20,000
- 20,001 - 30,000
- 30,001 - 50,000
- 50,001 - 100,000
- më shumë se 100,000
- Përforcim + Diversifikim  
(drejt sektorit bazë të bujqësisë)
- Përforcim + Diversifikim  
(drejt sektoreve bazë të bujqësisë dhe industrisë përpunuese)
- Përforcim + Kooperim  
(te sektoreve urbane të bujqësisë + turizmit)
- Përforcim + Diversifikim  
(ri sektoreve urbane të energjisë dhe bujqësisë)
- Rigjenerim + Përforcim  
(drejt sektoreve bazë të ekoturizmit + bujqësisë)
- Konsolidim, densifikim + përforcim



LEGJENDA

- Rrugë primare
- Rrugë sekundare
- Rrugë terciare
- Rrugë të propozuara
- Rrugë të rrejtit evropian tranzitor
- Infrastruktura hekurudhore
- Hekurudhë e propozuar
- Stacion kryesor
- Stacion vetëm për mallra
- Stacion pasagjerësh
- Piki kulturre
- Rrugë bregdetare peluzhistike
- Itinerar peizazhistik ndërlidhës
- Itinerar vozitës
- Fshat turistik
- Zona UNESCO
- Pyje
- Toka me kultivim kompleks
- Depozitë hekur - nikeli
- Minerë hekur - nikeli - aktive
- Minerë hekur - nikeli - e mbyllur
- Minerë hekur - nikeli - në stud
- Depozitë bakri
- Minerë bakri
- Fabrika e pasurimit të bakrit
- Depozitë kromi
- Minerë kromi - aktive
- Minerë kromi - e mbyllur
- Minerë kromi - në studim
- Fabrika e pasurimit të kromit
- Minerë baltami
- Furra e shkrirjes së bitumit
- Depozitë qymys - guri
- Depozitë jo - metalore
- Vreshtari
- Pemë frutore
- Ullishte
- Vend depozitim
- Hotspots
- Vend depozitim i propozuar
- Fusha gaz
- Fusha naftë
- Rafineri naftë
- Termocentral i propozuar
- Termocentrale inaktive
- Central biomase
- Kompresor gaz
- Hidrocentrale të vogla
- Hidrocentrale kryesore
- Nënstacione
- Linjë transmissori
- Linjë transmissori në ndërtim
- Linjë të propozuara
- Linjë gazi
- Linjë gazi e propozuar (PPO)
- Qendër primare
- Qendër sekundare
- Qendër terciare
- Aeroport
- Port kryesor
- Port energjetik
- Marinë turistike
- Zona të mbrojtura



## 2.4. Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar

Zona në studim, sipas PINS Bregdetit, bën pjesë në fashën 3, rajoni agrikor.

Plani orienton zhvillimin drejt kultivimit bujqësor, të kombinuar me zhvillimin e turizmit rural dhe agroturizmit duke përdorur produktet “BIO” të shkallës së vogël dhe të mesme për të mbështetur zinxhirin ushqimor “slow-food”.

Gjithashtu, PINS Bregdeti evidenton këtë fashë si me potencial të lartë për zhvillimin ekonomik në degën e peshkimit dhe në atë të akuakulturës.




- |   |   |  |
|---|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>⊙ Qendër parësore</li> <li>⊕ Qendër dytësore</li> <li>● Qendër terciare</li> <li>○ Qendër lokale e specializuar</li> <li>• Lokalitet i specializuar</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>Zonë e urbanizuar</li> <li>Kufi i rajonit të planifikimit të PINS Bregdetit</li> <li>Vija e ndërtimit (200m gëatës/60m lartësi) nga vija e ujit</li> <li>Rrugë parësore</li> <li>Rrugë bregdetare peizazhistike</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>B1 Sistemi bujqësor</li> <li>N1 Sistemi natyror</li> <li>U1 Sistemi urban</li> <li>Zonë e mbrojtur mjedisore</li> <li>ABC Tipologjia e plazhit</li> </ul> |
|---|---|--|



## 2.5. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Divjakë

Në bazë të përdorimit të tokës sipas PPV Bashkia Divjakë, sistemi që i përket zonës në studim është ai Natyror. PPV Divjakë përcakton kushtin e hartimit të PDZRK-së për pjesën më të madhe të territorit në studim, sikurse tregohet në tabelat më poshtë.

Veë përdorimeve Tokë Natyrore (N) dhe Tokë Bujqësore (B), PPV jep gjithashtu orientime për zhvillimin e ekoturizmit dhe shërbimeve turistike, lidhur me potencialin e zonës.



Sistemi	Natyror	Natyror	Natyror	Natyror
Kodi i sistemit	N	N	N	N
Kategoria	Zona natyrore	Zona natyrore	Zona natyrore	Zona natyrore
Kodi i kategorisë	N	N	N	N
Zona	Toka të kripura	Toka të kripura	Pyjet	Pyjet
Kodi i zonës	N4	N4	N1	N1
Kodi i njësisë	<b>N4-ZPQ</b>	<b>N4</b>	<b>N1-ZPQ2</b>	<b>N1</b>
Sipërfaqe (ha)	798.21	1429.74	287.86	2929.30
Dendësia e propozuar (Banim/Përdorim)				
PDV	PDZRK	Jo	PDZRK	Jo
Lloji i ndërhyrjes	Mbrojtja	Mbrojtja	Mbrojtja	Mbrojtja
Pop. E pritshme				
KSHP	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit
KSHT	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit

KSHT	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit
KSHR	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit
Intensiteti	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit
Intensiteti me kusht	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit
Lartësia	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit
Shërbime	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PDZRK	Sipas planit të peizazhit

Sistemi	Bujqësor	Bujqësor	Infrastrukturor	Infrastrukturor	Infrastrukturor
Kodi i sistemit	B	B	IN	IN	IN
Kategoria	Zona bujqësore	Zona bujqësore	Infrastrukturë	Infrastrukturë	Infrastrukturë
Kodi i kategorisë	B	B	IN	IN	IN
Zona	Toka are	Toka bujqësore me bimësi të lartë	Rrugë	Kanalet e kullimit dhe vaditjes	Hidrovor
Kodi i zonës	B2	B3	IN1	IN6	IN8
Kodi i njësisë	<b>B2-01</b>	<b>B3</b>	<b>IN1</b>	<b>IN6</b>	<b>IN8-02</b>
Sipërfaqe (ha)	56.27	918.64	619.62	258.29	0.26
Dendësia e propozuar (Banim/Përdorim)					
PDV	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Lloji i ndërhyrjes	Mbrojtja	Mbrojtja	Rezervim	Rezervim	Rezervim
Pop. E pritshme					
KSHP	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS
KSHT	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS
KSHR	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS
Intensiteti	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS
Intensiteti me kusht	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS
Lartësia	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS
Shërbime	Përcaktohet në PDV		Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Përcaktohet në PVS



### 3. Propozimet territoriale

#### 3.1. Përdorimi i Tokës

Duke u mbështetur në orientimet e dokumenteve të sipërpërmendura, zona në studim shihet si potenciale për nxitjen e zhvillimit të projekteve në fushën e akuakulturës, agrikulturës, energjisë së rinovueshme dhe turizmin e përqëndruar, duke ruajtur vlerat natyrore.


Referuar vendimeve dhe propozimeve të sipërpërmendura të KIS-it dhe Këshillit të Ministrave, orientimet paraprake për përdorimin e tokës për PDZRK-në, jepen më poshtë.


Përdorimet e tokës, referuar Rregullores së Planifikimit, në përgjigje të vendimeve janë:

1. **Përdorimi Ekonomi Bujqësore [EB] dhe Tokë Bujqësore [B]** - Vendim i KIS, Nr. 6/9, datë 24.06.2020, ku jepet orientimi për zhvillimin e strukturave me karakter agroturistik; ndryshimi i Vendimit Nr. 6/4, datë 19.04.2018 ku jepej orientimi për zhvillimin e frutikulturës dhe strukturave mbështetëse për magazinimin dhe administrimin.
2. **Përdorimi Tokë Bujqësore [B] dhe Industri e Rëndë [IE]** - Vendim i KIS, Nr. 7/5, datë 07.01.2020, ku jepet orientimi kultivimin e kulturës së kallamit dhe për realizimin e një impianti prodhimi të paneleve MDE duke përdorur si lëndë të parë kallamin dhe mbetje të çdo lloji tjetër produkti agro-bujqësor me përbërje fibroze”.

Përtej këtyre përdorimeve të tokës, PDZRK jep orientimet si më poshtë për territoret e tjera:

1. **Përdorimi Natyrë dhe Argëtim [NAR]** me përdorime të lejuara Banim [A], Shërbime [S] dhe Aktivitete Shoqërore dhe Argëtimi [AR]- për njësinë që përfshin vendbanimin ekzistues të Adriatikut dhe parcelat në jug të tij deri në Emisarin e Myzeqesë. Kjo njësi orientohet drejt zhvillimit të aktiviteteve turistike në harmoni të plotë me zonën e mbrojtur.  
Zhvillimet në këtë njësi duhet të jenë subjekt i një plani më të detajuar, që duhet të hartohet posaçërisht për territorin e saj.
2. **Përdorimi Tokë Bujqësore [B] dhe Ekonomi Bujqësore [EB]** - për territorin në perëndim dhe jug të lagunës dhe në veri të Emisarit të Myzeqesë.  
Kjo njësi, e cila përfshin prona në menaxhim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, orientohet drejt kultivimit bujqësor dhe aktiviteteve ekonomike të lidhura me të, në përputhje të plotë me zonën e mbrojtur.
3. **Përdorimi Ekonomi Bujqësore [EB]** - për territorin në perëndim dhe jug të lagunës dhe në veri të Emisarit të Myzeqesë, ku jepet orientimi për zhvillimin e fermës së akuaponisë dhe strukturave mbështetëse.





### 3.2. Detajet e investimeve të miratuara

#### a. Akuakultura + Akuaponia / Bujqësi

**“FERMË AKUAPONI”, “AQUATIQ” SHPK (Miratuar si Investim Strategjik me Vendim Nr. 4/4, datë 19.04.2018)**

**Qëllimi i projektit** - realizimi dhe mirëmbajtjen e një ferme të akuaponisë, në zonën e Remasit, Divjakë në Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastasë, fermë e cila kap vlerën 5 milion Euro investim dhe hap 50 vende të reja pune me potencial shumëfishimi.

Subjekti do të aplikojë teknologjinë AQUAPONIK (AQUAculture + hydroPONIC), për të përfitur kultivimin e peshkut (trofta shumëngjyrëshe me 95% e prodhimit total të peshkut + trofta e Ohrit me 5%) dhe kultivimin e perimeve që rriten në ujë (domate të tipit qershij; sallatë (shumëgjethe) borzilok (ose barishte të tjera) në një sistem të mbyllur simbiotik, në sera, Projekti parashikon kombinimin e dy cikleve të prodhimit, duke siguruar procesin e prodhimit të peshkut si dhe transferimin e produkteve metabolike të tij në lëndë organike ushqyese të vlefshme për perimet. Këto lëndë ushqyese lëvizin së bashku me ujin që del nga zona e akukulturës në serën hidroponike dhe u siguron bimëve pleh natyral.

Sipërfaqja fillestare prej 1.3 ha pjesë e planit të “AQUATIQ” sh.p.k është bërthama fillestare ku do të implementohen projekti. Brenda 3 vitesh nga periudha e sipërpërmendur parashikohet mbulimi me sera i një sipërfaqe prej 10 ha dhe më tutje brenda një afati 7 – 10 vjeçar parashikohen të mbulohen me sera të 120 ha të kërkuar (aktualisht tokë e kripur). Implementimi i njësisë qëndrore parashikon të marrë një kohë prej 15 muajsh dhe pastaj në muajin e 16 fillon prodhimi dhe shitja.

**Ndikimi në mjedis** - Ndërhyrja në tokë djerrë në fshatin Adriatik do të rrisë vlerën e zonës së pazhvilluar. Të gjitha produktet e kultivuara do të jenë bio dhe nuk do të përdoren pesticide apo plehra kimikë për rritjen e tyre, nga ku lind dhe qëllimi i Shoqërisë, i cili është të shumëfishojë prodhimin duke ruajtur cilësinë e dëshiruar.

Sistemi i përdorur në tërësi është një teknikë novatore, e cila përbën një hap të rëndësishëm drejt prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit, duke pasur mundësi për të vjelë dhe nxjerrë në treg prodhim të freskët pa ndërpreje dhe



njëkohësisht duke përdorur 90% më pak tokë dhe ujë në krahasim me modelet tradicionale të bujqësisë apo operacioneve standarde në serrë. Ndër të tjera, përdorimi i Akuaponisë redukton emetimin e CO<sub>2</sub>, pasi dioksidi i karbonit i emetuar nga peshqit shfrytëzohet nga bimët në procesin e fotosintezës.

*b. Agroturizmi*

**“Realizimi i plantacionit me Shegë, Goji Berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimi i Agroturizmit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, bashkia Divjakë”, me subjekti aplikues “Agro Iliria Group” SHPK (Miratuar si investim strategjik me Vendimin Nr. 6/9, datë 24.06.2020)**

**Qëllimi i projektit** - ngritjen e plantacionit me Shegë, Goji Berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimi i Agroturizmit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, bashkia Divjakë, i cili përdor në total një truall prej 496.6 ha, në Zonën Kadastrale Nr. 2085.

“Agro Iliria Group” Shpk ka përgatitur një plan më të detajuar të mbjelljes së kulturave duke kryer teste specifike, në zonën e venë në dispozicion, për të evidentuar faktorët biologjikë, të cilë ndikojnë drejtpërsëdrejti në prodhimin bujqësor dhe se rezultatet e testeve kanë treguar së për kulturat e finger lime dhe avokado toka e kripur është jokualitative dhe joproduktive, prandja është i nevojshëm zëvendësimi i kulturave me kivi, rrush, dardhë etj. Gjithashtu është kërkuar ndryshimi pjesor i projektit duke parashikuar dhe zhvillimin e agroturizmit në zonë.

*c. Albapanel / Industri*

**“Kultivimi i kallamit të egër për përdorim në industrinë e përpunimit të drurit”, me subjekti aplikues “Albapanel” NGR (Miratuar si investim strategjik me Vendimin Nr. 7/5, datë 07.01.2020)**

*ç. Adriatiku – zhvillime eko-turistike*

Kjo zonë zhvillohet sipas përcaktimeve të PPV-së së Bashkisë Divjakë. Zona e vetme pjesërisht urbane e PDZRK-së, e cila synohet të orientohet drejt zhvillimit të turizmit miqësor me natyrën.

### **3.3. Plani i infrastrukturave teknike**

PDZRK jep orientime të përgjithshme për infrastrukturat teknike lidhur me zhvillimet e propozuara në zonë.

Përcaktohet rrjeti rrugor kryesor (Rrugë Lokale – F), i cili i jep akses njërive sipas përdorimeve përkatëse, ndërkohë që zhvillimet brenda secilës njësi duhet të detajojnë infrastrukturën gjatë fazës së projektimit.


Infrastruktura e ujësjellësit shërben aktualisht vendbanimin e Adriatikut, ndërkohë që për qëllime bujqësore dhe aktivitetet e tjera të parashikuara, PDZRK lejon zgjidhjet lokale të pavarura nga rrjeti i përgjithshëm.

Kështu, lejohen pusët si infrastrukturë furnizimi me ujë, duke u detajuar në projektet përkatëse dhe duke respektuar rregullat e vendosura për zonën e mbrojtur.

Gjithashtu, infrastruktura e KUZ duhet të zgjidhet lokalisht në mënyrë të pavarur për secilin aktivitet, me grupa septike apo sipas rastit me impiante trajtimi në varësi të kapacitetit.

Infrastruktura energjetike për aktivitetet e lejuara lidhet me rrjetin ekzistues, paraqitur edhe në dokumentin e PPV Divjakë. Për arsye mbrojtje të biodiversitetit në PKDK, rrjeti duhet të shtrihet nëntokë në çdo rast.





### 3.4. Plani i mbrojtjes së Peizazhit

Në zonën mbrojtëse përgjatë bregut të Lagunës së Karavastës, duhet të bëhet mbjellje me pishë të butë (pinus pinea), me një gjerësi jo më të vogël se 200 m në veri dhe jo më të vogël se 100 m në pjesën perëndimore dhe jugore të lagunës, siç është paraqitur në hartën e përdorimit të tokës.

Përgjatë bregut të shtratit të vjetër të lumit Seman (lumi i vdekur), duhet të bëhet mbjellje me pishë të butë (pinus pinea), me një gjerësi jo më të vogël se 100 m, siç është paraqitur në hartën e përdorimit të tokës.



## Shtojca 1

### Vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike

- **Vendim i KIS, Nr. 4/4, datë 19.04.2018** “Për miratimin e statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit me potencial strategjik “Fermë akuaponi në Remas, Lushnjë” me subjekt aplikues “AQUATIQ” shpk me NUIS/NIPT L71320011G”;
- **Vendim i KIS, Nr. 6/9, datë 24.06.2020**, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 6/4, datë 19/4/2018 të KIS "Për miratimin e statusit ‘Investim/Investitor strategjik, procedurë e asistuar’ për projektin e investimit me potencial strategjik “Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe finger lime në zonën e karavastasë bashkia divjakë”, me subjekt aplikues "agro iliria group" sh.p.k. NUIS/NIPT L51320033L”;
- **Vendim i KIS, Nr. 7/5, datë 07.01.2020**, “Për një ndryshim në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 7/1 prot, datë 05.12.2016 "Për miratimin e statusit ‘Investim/Investitor strategjik, procedurë e asistuar’ për projektin “Albpanel” me subjekt investues Albpanel NGR NUIS/NIPT: L61605017K për realizimin e një impianti prodhimi të paneleve MDE duke përdorur si lëndë të parë kallamin dhe mbetje të çdo lloji tjetër produkti agrobujqësor me përbërje fibroze”.



## Shtojca 2

### Harta

- i. Harta e kufirit të zonës në studim;
- ii. Harta e zonës në studim në raport me Zonimin e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta;
- iii. Harta e sistemeve
- iv. Harta e njësive strukturore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDIM

NR. <sup>21/</sup><sub>14</sub> DATË 19/04/2018

**PËR MIRATIMIN E STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK "FERMË AKUAPONI NË REMAS LUSHNJË" ME SUBJEKT APLIKUES AQUATIQ SHPK NUIS/NIPT L71320011G.**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 21 të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Sekretariatit Teknik, vlerësoi mbi projektin:

- Vlera e investimit të projektit "Fermë Akuaponi" plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 5,100,000 (pesë milion e njëqind mijë) Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazës së operimit, numri i personave të punësuar synohet të jetë 50 (pesëdhjetë) persona.
- Projekti synon ndërtimin dhe zhvillimin e një ferme të akuaponisë që kombinon akuakulturën konvencionale (rritjen e kafshëve ujore) me hidroponinë (kultivimin e bimëve në ujë). Projekti parashikon kombinimin e këtyre dy cikleve të prodhimit.

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik Fermë Akuaponi, me kusht që subjekti investues të nënshkruajë Marrëveshje të Garancive Financiare (MGF) me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.



2. Statusi strategjik "Investim/Investitor Strategjik me Procedurë të Asistuar" i jepet projektit të investimit "Fermë Akuaponi", për një periudhë dy vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të truallit prej përafërsisht 1,3 ha, në ZK. Nr.2085, Karavasta.
3. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:
  - a) Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
  - b) Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit;
  - c) Miratimin në parim dhe lejimin e përdorimit të truallit prej 1.3 ha me tarifën simbolike 1 Euro për realizimin e fermës së akuaponisë në ZK. Nr.2085, Karavasta, me kusht që hapësira e kërkuar të jepet në zonë zonën ku Bashkia Divjakë planifikon zhvillimin e akuakulturës. Miratimi përfundimtar, numri i saktë i parcelës, sipërfaqja, mënyra dhe afatet e lejimit të përdorimit të truallit në funksion të realizimit të fermës së akuaponisë do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas procedurave të legjislacionit për investimet strategjike.
4. Ky vendim miraton dhe planin e veprimit për çdo masë mbështetëse të kërkuar nga Shteti Shqiptar dhe miratuar me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike.
5. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik "Fermë Akuaponi" konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
6. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike.
7. Ngarkohen institucionet kompetente në zbatim të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" për hartimin e Planit të detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK) Karavasta.
8. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjenica Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

SENIDA MESI

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË  
ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
NIKO PELESHI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
BLENDI KLOBI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT  
ALMA HICKA



SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

*Sokol NANI*  
*Konofel*



## PLANI I VEPRIMIT

### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK FERMË AKUAPONI

#### 1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

#### Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin. Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### 2. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të Projektit Fermë Akuaponi

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit Fermë Akuaponi, projekt me potencial strategjik, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

#### 3. Hapat procedurale





Propozimi nga investitori:

Investitori Aqatiq shpk NUIS/NIPT 171320011G kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e masave mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Pas vlerësimit, masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandim	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në fazë. Detyrmet sipas institucioneve të përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
<b>Përdorim i pasurisë së paluajtshme shtetërore për realizimin e projektit</b>	<p><b>PO</b></p> <p>Projekti i investimit të ndihmohet nga Shteti Shqiptar duke i vënë në dispozicion vetëm sipërfaqen që justifikon në dokumentacionin teknik të dorëzuar, në zonën kadastrale Nr. 2085, sipërfaqe 1.3 ha, e llojit arë, nën administrim të MBZHR.</p> <p>Sqarim. Subjekti në kërkesën e tij parashikon marrjen në përdorim të një sipërfaqe prej 120 ha, por justifikon vetëm përdorimin e një sipërfaqe prej 1,3 ha)</p>	<p><b>MBZHR</b></p> <p><b>MFE</b></p> <p><b>ZVRPP</b></p> <p><b>LUSHNJË</b></p>	<p>Vënja në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, rregullohet rast pas rasti, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin mbi administrimin e pronës publike.</p> <p>MFE do të propozojë në Këshillin e Ministrave, VKM për kallimin e parcelës në fjalë në fondin e investimeve strategjike sipas VKM Nr.</p>		Pas vendimit të KIS	Nuk ka



<p>Kusht:</p>	<p>Subjekti duhet të vërtetojë mundësinë reale të financimit të projektit</p> <p>Do të nënshkruhet marrëveshje e garancive financiare ndërmjet subjektit investues dhe Ministrisë MFE</p> <p>Do të nënshkruhet gjithashtu në vijim Kontrata e Qirasë ndërmjet subjektit investues dhe MFE</p>	<p>MFE</p>	<p>1030, datë 16.12.2015 dhe dhënie në përdorim të kësaj parcele me tarifën simbolike 1 Euro, subjektit Aqatliq shpk. për realizimin e fermës së akuaponisë.</p> <p>Nënshkrimi i MGF realizohet në përputhje me VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015</p>			<p>Nuk ka</p>
<p>Marrja e licencave/lejeve/autorizimeve pas</p>		<p>Pas përfundimit të statusit strategjik, AIDA luan</p>	<p>Procedurat e përshpejtuara për përfundimin e</p>			



përfitimit të statusit Investim/investitor strategjik procedurë e asistuar		rollin e agjentit asistues të subjektit	lejeve/licenca ve/autorizime bazohen në VKM Nr. 1029, datë 16.12.2015			
--	--	---	---	--	--	--

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**SENIDA MESI**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË  
ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
NIKO PELESHI**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
BLENDI KUCI**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT  
ALMA HICKA**



SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

**Sokol NANO**

*[Handwritten signature]*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 6/9, DATË 24/06/2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 6/4 DATË 19/4/2018 TË KIS "PËR MIRATIMIN E STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK "NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, GOJI BERRY, AVOKADO DHE FINGER LIME NË ZONËN E KARAVASTASË BASHKIA DIVJAKË", ME SUBJEKT APLIKUES "AGRO ILIRIA GROUP" SH.P.K. NUIS/NIPT L51320033L"

Në mbështetje të Nenit 8, 9, 10, 17, 18, 21, Kreut VII të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë" dhe Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë:

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike, me Vendimin Nr. 6/4 datë 19/4/2018 "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe finger lime në zonën e Karavastasë Bashkia Divjakë", me subjekt aplikues "Agro Iliria Group" shpk NUIS/NIPT L51320033L, ka vendosur miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik, në një sipërfaqe toke prej 800 ha, pasi të bëheshin verifikimet kadastrale të zones;
- Pas verifikimeve kadastrale të zones, për këtë projekt u miratuan dy Vendime të Këshillit të Ministrave, përkatësisht VKM Nr. 355, datë 20.04.2018 dhe VKM Nr. 619 datë 18.09.2019, të cilët miratuan kalimin në Fondin e Pasurive Të Paluajtshme Për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) të sipërfaqes totale prej 496.6 ha dhe vënien në dispozicion të projektit;





- Duke qenë se subjekti aplikues ka përgatitur një plan më të detajuar të mbjelljes së kulturave duke kryer teste specifike, në zonën e vënë në dispozicion, për të evidentuar faktorët biologjikë, të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në prodhimin bujqësor dhe se rezultatet e testeve kanë treguar se për kulturat e *finger lime* dhe *avokado* toka e kripur është jokualitative dhe joproductive, subjekti propozues argumenton se është e nevojshme zëvendësimi i kulturave me kivi, rrush, dardhë etj;
- Subjekti ka paraqitur kërkesë edhe për ndryshimin e vendimit Nr. 6/4 datë 19/4/2018 të KIS, pasi plani i biznesit të shoqërisë ka pësuar një ndryshim pjesor duke parashikuar dhe zhvillimin e agro-turizmit në këtë zonë;
- Duke qenë se lloji i projektit të synuar nuk ka ndryshuar dhe vlera e investimit me numrin e punësimit plotësojnë kriteret e parashikuar nga legjislacioni;

## KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

### VENDOSI:

1. Ndryshimin e Vendimit Nr. 6/4, datë 19/4/2018 "Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, avokado dhe *finger lime* në zonën e Karavastasë Bashkia Divjakë", me subjekt aplikues "Agro Iliria Group" shpk Nuis/Nipt L51320033L, si më poshtë vijon:

1. *Miratimin e Statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar" për projektin e investimit me potencial strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë".*
2. *Subjekti propozues duhet të nënshkruajë Marrëveshje të Garancive Financiare (MGF) me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.*
3. *Statusi strategjik "Investim/Investitor Strategjik me Procedurë të Asistuar" i jepet projektit të investimit "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë", për një periudhë 3 (tre) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të truallit prej 496.6 ha, në ZK. Nr.2085, i cili përcaktohet nëmjetmërisht nga Vendimit të Këshillit të Ministrave.*
4. *Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:*
  - a. *Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;*
  - b. *Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit;*
  - c. *Miratimin në parim dhe lejimin e përdorimit të truallit me sipërfaqe 496.6 ha, me tarifën simbolike 1 Euro, për realizimin e fermës "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj."*





dhe zhvillimin e agroturizimit, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”.

5. Ky vendim miraton dhe planin e veprimit për çdo masë mbështetëse të kërkuar nga subjekti dhe miratuar me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike.
6. Në zbatim të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408 datë 15.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të bëhet rishikimi i PDZRK-së mes Lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman, të miratuar me vendimin e KKT nr. 3 datë 26.07.2018, përpara aplikimit për lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit.
7. Ministri i Ekonomisë dhe Financës ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e pasojave, ndryshim të VKM Nr. 355 datë 20.04.2018 dhe VKM Nr. 619 datë 18.09.2019, sipas parashikimeve të këtij vendimi.
8. Subjekti nuk duhet të ndryshojë më projekt investimin dhe në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik "Ngritja e plantacionit me shëgë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë" konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
9. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike.
10. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**





ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
ERION BRAÇE

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË  
ANILA DENAJ

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
BLENDI KLOSI

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
BLEDI ÇUÇI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT  
ENKELEJDA MUÇAJ



SEKRETARIATI TEKNIK I KIS  
SOKOL NANO





## PLANI I VEPRIMIT

### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK "NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, GOJI BERRY, KIVI, RRUSH, DARDHË, SI DHE ZHVILLIMIN E AGROTURIZIMIT NË NJË SIPËRFAQE RRETH 131 HA, NË ZONËN E KARAVASTASË, BASHKIA DIVJAKË".

#### 1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

#### Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### 2. Hapat procedurale


Masa mbështetëse të miratuara janë si më poshtë vijon:






INVESTIMET

Masat mbështetëse	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në fazë.	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
<p>Përdorimi i truallit prej 496.6 ha, në ZK. Nr.2085 në funksion të realizimit të projektit "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë, si dhe zhvillimin e agroturizmit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastës, Bashkia Divjakë".</p>	<p>PO</p>	<p>AKPT AKZM MBZHR MFE BASHKIA DIVJAKË</p>	<p>Piani i Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDKRZ) Karavasta - Seman, nuk ka parashikuar zhvillime me karakter agroturistik;</p> <p>Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të Territorit", i ndryshuar dhe VKM Nr. 408</p>	<p>Pas zbardhjes së Vendimit të KIS</p>		





<p>- Ndryshim të VKM Nr. 355 datë 20.04.2018 dhe VKM Nr. 619 datë 18.09.2019, sipas parashikimeve të këtij vendimi të Komitetit të Investimeve Strategjike.</p>	<p>MFE</p>		<p>datë 15.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, do të nevojitet rishikimi i PDZRK-së përpara aplikimit për lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit.</p>		<p>Pas rishikimit të PDZRK</p>
<p>Kusht: Subjekti duhet të vërtetojë mundësinë reale të financimit të projektit. Do të nënshkruhet marrëveshje e garancive financiare MGF ndërmjet subjektit investues dhe Ministrit të MFE</p>	<p>MFE</p>		<p>Nënshkrimi i MGF realizohet në përputhje me VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015</p>		



SE-  
INVESTIMEVE

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
ERION BRAÇE**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË  
ANILA DENAJ**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
BLENDI KLOSI**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
BLEDI ÇUÇI**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT  
ENKELEJDA MUÇAJ**



**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

**SOKOL RABO**



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 7/5, DATË 7.01 /2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 7/1 PROT, DATË 05.12.2016 "PËR MIRATIMIN E STATUSIT STRATEGJIK 'INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK, PROCEDURË E ASISTUAR' PËR PROJEKTIN "ALBPANEL" ME SUBJEKT INVESTUES ALBPANEL NGR NUIS/NIPT: L61605017K PËR REALIZIMIN E NJË IMPIANTI PRODHIMI TË PANELEVE MDE DUKE PËRDORUR SI LËNDË TË PARË KALLAMIN DHE MBETJE TË ÇDO LLOJI TJETËR PRODUKTI AGRO - BUJQËSOR ME PËRBËRJE FIBROZE"**

Në mbështetje të Nenit 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendim Nr. 7/1 Prot, datë 05.12.2016 "Për miratimin e statusit strategjik 'Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar' ka vendosur miratimin e statusit strategjik për projektin "Albpanel" me subjekt investues Albpanel NGR NUIS/NIPT: L61605017K për realizimin e një impianti prodhimi të paneleve MDE duke përdorur si lëndë të parë kallamin dhe mbetje të çdo lloji tjetër produkti agro - bujqësor me përbërje fibroze, me kusht nënshkrimit e Marrëveshjes së Garancive Financiare";
- Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 727, datë 8.12.2017 ka vendosur transferimin e pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-112-127-D, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, njësia administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-D), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, Zona Kadastrale Nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Albpanel";



- Marrëveshja e Garancive Financiare dhe Kontrata e Përdorimit të Tokës janë lidhur ndërmjet subjektit Albpanel NGR dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë më datë 05.10.2018;
- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendim Nr.7/4, datë 04.03.2019 “Për shtyrjen e Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit me potencial strategjik “Albpanel” vendosi shtyrjen e afatit të statusit strategjik me dy vite të tjera;
- Subjekti Albpanel NGR paraqet kërkesë për ndryshim të parcelave për realizimin e projektit, pasi nga analizat periodike të realizuara në Laboratorin e Universitetit Bujqësor të Kamzës, laborator i deklaruar në Kontratën e Përdorimit të Tokës Nr.5305 Rep, Nr.739 Kol, dt.05/10/2018., ndërmjet subjektit Albpanel NGR dhe Ministrisë të Financës dhe Ekonomisë, rezulton se kjo tokë është e papërshtatshme për të kultivuar kulturën e kallamit, pasi është e ngarkuar me elementë që e bëjnë të pamundur kultivimin dhe përmirësimi i kushteve të tokës kërkon implementim nga ana e subjektit të një buxheti që tejkalon parashikimin në plan investimi dhe plan biznesi;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë paraqet propozim për ndryshim të zonës së përfutur në bazë të Vendimit të KIS Nr. 7/1, datë 05.12.2016, rinovuar statusi strategjik me Vendim të KIS Nr. 7/4, datë 04.03.2019 për subjektin Albpanel NGR.

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE  
VENDOSI:**

1. Ndryshimin e Planit të Veprimit miratuar me Vendim Nr. 7/1 Prot, datë 05.12.2016 të Komitetit të Investimeve Strategjike “Për miratimin e statusit strategjik “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” për projektin “Albpanel” me subjekt Albpanel NGR NUIS/NIPT: L61605017K”.
2. Duke qenë se potenciali strategjik i projektit të investimit “Albpanel” ka një vlerësim pozitiv nga grupi operacional që ka shqyrtuar projektin dhe nga Komiteti i Investimeve Strategjike, subjekti propozues i këtij projekti, Albpanel NGR NUIS/NIPT: L61605017K, të ndihmohet nga Shteti Shqiptar duke i vënë në dispozicion një tokë tjetër, me të njëjtën sipërfaqe sipas Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 7/1, dt. 05.12.2016, në zonën DJ\_B\_B\_1, sipas PDZRK miratuar me Vendim të KKT Nr. 3, datë 26.07.2018.
3. Ministri i Ekonomisë dhe Financës dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e pasojave, ndryshim të VKM Nr. 727, datë 8.12.2017; ndryshim të Kontratës së Përdorimit të Tokës Nr.5305 Rep, Nr.739 Kol, dt.05/10/2018; ndryshim të Marrëveshjes Nr. 16331/2, datë 05.10.2018 mbi Mënyrën e Realizimit të Projektit të Investimit “Albpanel” me Status Strategjik Procedurë e Asistuar dhe Garancitë Financiare, ndërmjet subjektit Albpanel NGR dhe



Ministrit të Financës dhe Ekonomisë, ndryshime të mundshme në PDZRK Karavasta, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për regjistrimet e nevojshme për zonën e re që do i vihet në dispozicion projektit Albpanel.
5. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**ERION BRAÇE**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**ANILA DENAJ**

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**BLEDI ÇUÇI**



**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**BLENDI KLOS**

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
**ARTUR METANI**



Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i ndryshuar  
Kufiri i PDZRK-së




- Legjenda**
- - - Kufiri Administrativ
  - ▭ Kufiri i PDZRK
  - Qender lokale
  - Objekte
  - Hidrografia
  - Rruge
  - Kanale vaditëse e kulluese
  - - - Izoipse




**AKPT**  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TERRITORIAL

Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësishme Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i ndryshuar  
Zona e PDZRK dhe Zonimi i PKDK sipas Planit të Menaxhimit




**Legjenda**

- Kufiri Administrativ
- Kufiri i PDZRK
- Qendrit lokale
- Objekte
- Hidrogralia
- Rrugë
- Kanale vaditëse e kultivuese
- Izopse
- Kisha e Shen Thanasit
- Zonimi i PKDK
- Nënzona qëndrore
- Nënzona e përdorimit të qëndrueshëm
- Nënzona e përdorimit tradicional
- Nënzona rekreative
- Nënzona detare





**AKPT**  
AGJENCIA KOMBËTARE E  
PLANIMIT TERRITORIAL





Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i ndryshuar  
Harta e Sistemeve



Legjenda



- - - Kufiri Administrativ
- Kufiri i PDZRK
- Qendër lokale
- Objekte
- Sistemi urban
- Sistemi infrastrukturor
- Sistemi bujqësor
- Sistemi natyror
- Sistemi ujor
- Zonë mbrojtëse (buffer) (vija blu)



**AKPT**  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIMIT I TERITRIORIT

MINISTRIA E PLANIMIT I TERITRIORIT DHE ZHVILLIMIT I TERITRIORIT  
MINISTRIA E Mbrojtjes së mjedisit dhe planimit të territorit  
MINISTRIA E Urbanizimit dhe ndërtimit të shtërive

Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman, i ndryshuar  
Harta e Njësive Strukturore



Legjenda

- - - Kufiri Administrativ
- Kufiri i PDZRK
- Qendër lokale
- Objekte
- ▭ Njësi strukturore
- Zonë mbrojtëse (buffer) (Vija Blu)
- ZM Nënzona e përdorimit të qëndrueshëm
- ZM Nënzona e përdorimit tradicional
- ZM Nënzona qendrore
- ZM Nënzona rekreative
- ZM Nënzona detare



**AKPT**  
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIMIT DHE TERRITORIALE